



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:138402
Datë: 03.05.2024
Numri i dokumentit: 05652151

Ac.nr.8160/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.C, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat. A.M, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, për kompensimin e pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.445/20, të datës 06.04.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 03.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.445/20, të datës 06.04.2021 dhe gjykohet si në vijim: REFUZHET si e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit Sh.C, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Rahovecit, që paditësit Sh.C, t'ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar për 23 vite përvojë pune, shumën prej 912.00 euro si dhe në emër të pagave përcjellëse me rastin e pensionimit t'ia paguaj shumën prej 912.00 euro, në total shumën prej 1,824.00 euro, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8% nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.445/20, të datës 06.04.2021, ka vendosur si vijon: MIRATOHET kërkesëpadia e paditësit Sh.C si dhe DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit, që paditësit në emër të pensionimit t'ia paguaj dy paga mujore në lartësi të pagës mesatare për tre muajt e fundit, në shumë prej 912.00€ dhe në emër të shpërblimit jubilar për njëzetë e tri (23) vite pune të pandërprere dy paga mujore në shumë prej 912.00 €, apo gjithsejtë shumën prej 1,824.00 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së marrjes së këtij aktgjykimi (06.04.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7

ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, SI ME BAZË. DETYROHET e paditura që në po të njëjtin afat, paditësit t'ia paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 364.00 Euro, me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e të paditurës ta aprovoj, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me propozim që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pa bazë dhe aktgjykimi i atakuar të vërtetohet si dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës për përpilimin e përgjigjes në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e themeltë..

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi Sh.C, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me dt.17.10.2020, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, për kompensimin e pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, me detaje të përshkuara si në padi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.445/20, të datës 06.04.2021, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ndër tjera ka konstatuar se: në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi tek e paditura ka qenë në marrëdhënie pune, të caktuar në vendin e punës si Shef i Zyrës së regjistrimit të biznesit pranë Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm dhe se me vendim të kryetarit të Komunës së Rahovecit të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës dt.01.01.2015, vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marrë duke u bazuar në dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, ndërsa vendimin mbi kamatën gjykata e shkallës së parë e ka marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, për këtë gjë u desh që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të gjykohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit lidhur me kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, të dt.01.01.2015, kur paditësit ia ka njohur të drejtën për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, ku në nenin 52 shprehimisht parashihet se: *‘I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 2.Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. 3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf, ndërsa në nenin 53 shprehimisht parashihet se: ‘punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, qe i ka marr për tre (3) muajt te fundit’.* Këto dispozita përcaktojnë të drejtën e punëtorit për shpërblim jubilar dhe pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, mirëpo në rastin konkret themelësia e kërkesëpadisë nuk ka mundur të mbështetet në këto dispozita, për shkak se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka filluar të zbatohet nga data 01.01.2015 me kohëzgjatje të zbatimit për tri vite përkatësisht deri me datën 31.12.2017, ndërsa paditësi 20 vite të përvojës së punës i ka përmbushur në vitin 2012 si dhe moshën e pensionimit e ka arritur në vitin 2019, do të thotë paditësi vitin jubilar dhe moshën e pensionimit e ka arritur në një periudhë kohore në të cilën, Marrëveshja e lartcekur nuk ka qenë në fuqi dhe si e tillë nuk mund të prodhojë efekt juridik, gjegjësisht të aplikohet në mënyrë retroaktive, e nga kjo rezulton se paditësit i mungon baza ligjore për realizimin e kërkesës së parashtruar në padi. Këtë fakt e mbështet edhe qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, referuar mendimit juridik të saj (*mendimi juridik për shpërblim jubilar dt.27.02.2023, faqja 1 dhe 2, parag.II*), ku parashihet se: Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e lidhur më datë 18.03.2014, dhe nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), (në tekstin e më tejme: Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës) aplikohet në periudhën kohore nga data 01.01.2015-31.12.2017.

Gjykata e Apelit, vendimin për shpenzimet e procedurës, që secila palë t’i bart shpenzimet e saj të procedurës, e ka bazuar në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit në bazë të nenit 194, 195 par.1 pika e), lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.8160/21, me datë 03.05.2024

Kryetar i Kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku